



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KONSULTATIV I BIZNESIT

**Mbledhja e Keshillit Konsultativ te Biznesit,
E Premte, 21/12/2007, ora 12.00**

Minutat e takimit

Sot me date 21.12.2007 ora 12.00 prane ambjenteve te Ministrise se Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes (METE) u zhvillua mbledhja e rradhes se Keshillit Konsultativ te Biznesit (KKB) duke ndjekur kete rend dite:

Rendi i Dites:

- Diskutim mbi projektligjin “Për Shoqërite Tregtare”
- Diskutim mbi projektligjin “Për Nënshkrimin Elektronik”
- Diskutim mbi projektligjin “Për organizimin e Panairove dhe Ekspozitave Tregtare”
- Të ndryshme

Mbledhja u kryesua nga Kryetari i KKB-se Z. Genc Ruli, Minister i Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, dhe moren pjese shumica e anetareve. Ne kete mbledhje ishin te ftuar dy eksperte te GTZ, Z. Shpati HOXHA dhe Z.Damian GJIKNURI. Pas prezantimit qe ju be projektligjeve nga Kryetari Z.Genc RULI, ekspertet lolake te GTZ prezantuan perpara anetareve te KKB, dy projektligje ate “Për Shoqërite Tregtare” dhe “Për Nënshkrimin Elektronik”.

Gjithashtu ne kete mbledhje u prezantua projektligji “Për organizimin e Panairove dhe Ekspozitave Tregtare” projektligj i pergatitur nga Drejtoria e Nxitjes Biznesit.

Pas diskutimit te anetareve te KKB, rreth ketyre projektligjeve, nga kjo mbledhje rezultuan keto sugjerime:

1. P/ligji per shoqerite tregtare

Megjithese ky projektligj eshte paraqitur dhe ka kaluar ne nje proces te gjate konsultimi dhe veprimesh, ai u vleresua si pozitiv ne teresine tij nga anetaret e KKB. Pas prezantimit qe ju be ketij projektligji nga eksperti i GTZ, i cili theksoi se ky projektligj eshte hartuar sipas parimeve dhe direktivave te Bashkimit Europian, u argumetua nevoja qe ka kuadri ligjor ne fuqi per nje ligj te tille per shoqerite tregtare.

Gjate diskutimit per kete projektligj u pa e nevojshme nga anetaret e KKB rishikimi i dispozitave te ketij projektligji per pergjegjesine personale te aksionereve, pra nese ortaket e shoqerise do te pergjigjen vetem me pasurine e tyre ne shoqeri apo, sebashku me pasurine e tyre vetjake. Lidhur me kete projektligj u sygjerua rishikimi gjuhesor i ketij projektligji ne teresine e tij.

2. Projektligji “Për nënshkrimin elektronik”

Projektligji “Për nënshkrimin elektronik” u paraqit si një kërkesë e domosdoshme për të bërë të mundur që t’i hapet rrugë nevojës që ka sot praktika administrative, me qëllim që komunikimi elektronik dhe tregtia elektronike të përdorin “nënshkrimet elektronike” dhe shërbimet e lidhura me to.

- Zhvillimi i vullshëm i teknologjisë së informacionit dhe mënyra globale e përdorimit të internetit kërkojnë një qasje ligjore, e cila të jetë e hapur ndaj teknologjive dhe shërbimeve të ndryshme, të ngritura mbi sisteme hardware dhe software dhe që bëjnë të mundur vërtetimin me origjinalin të të dhënave në mënyrë elektronike.

- Një kuadër i qartë dhe i plotë ligjor do të bëjë të mundur që të rritet besimi në aplikimin e teknologjive të reja, në praktikat që lidhen me lëvizjen e mallrave dhe shkëmbimet tregtare.

- Lëvizja e lirë e mallrave bën të domosdoshme përafrimin e praktikave dhe aplikimeve që sigurojnë lëvizjen e lirë të mallrave jo vetëm brenda vendit, por dhe jashtë tij. Gjithashtu, krijimi i besimit që, standartet e nënshkrimeve elektronike janë në të njëjtin nivel si në Komunitetin Europian kërkon që, edhe legjislacioni të jetë brenda këtyre kërkesave të sigurisë dhe praktikave të njëjta për çertifikim, mbikqyrje etj.

- Hartimi i këtij ligji nisur nga sa më sipër, u bazua në Direktivën e 1999/93/EC për “Nënshkrimet elektronike” për të qenë në përputhje të plotë me standartet e BE-së në këtë fushë, ku siguria dhe besimi është një prioritet, por dhe për të bërë të mundur standartizimin e praktikave të parashikuara nga kjo Direktivë për vendet anëtare të BE-së. Të njëjtin model kanë ndjekur edhe shumë vende candidate të BE, dhe Shqipëria është nga vendet e pakta që nuk disponon një rregullim ligjor për firmën elektronike.

- Krijimi i kuadrit ligjor të ri, për krijimin e Qendres Kombëtare të Biznesit, për prokurimin publik, për pagesat e taksave në rrugë elektronike, e bëjnë të domosdoshëm miratimin e këtij ligji.

Pas diskutimit të këtij projektligji nga anëtarët e KKB, nuk pati kontestime apo sygjerime për këtë projek-ligj, por disa pyetje teknike lidhur me pagesën online të tatimeve, të cilat u sqaruan nga ekspertët përkatës i GTZ. Nga anëtarët e KKB u vlerësua iniciativa për të rregulluar në mënyrë ligjore nënshkrimet elektronike si dhe shërbimet e lidhura me to. Ky projek-ligj u vlerësua profesional në mënyrën e përgatitjes dhe në përputhje me direktivat e BE.

3. Projektligji “Për organizimin e panaiereve dhe ekspozitave tregtare”

Projektligji “Për panaiet dhe ekspozitat tregtare” u paraqit si një projektligj i cili ka si qëllim të nxisë organizimin e panaiereve dhe ekspozitave tregtare në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar, panaiet e specializuara brenda vendit, si dhe pjesëmarrjen e ekspozuesve vendas në panaiet ndërkombëtare jashtë vendit, me synimin për të prezantuar më së miri aftësitë teknike, teknologjike e shkencore të sektorëve të ndryshëm prodhues dhe të shërbimit, arritjet dhe zhvillimin e ekonomik të shtetit shqiptar, nxitjen e investimeve në vend, si dhe promovimin e eksporteve tona jashtë vendit.

Deri tani për rregullimin e këtyre veprimtarive ka shërbyer VKM nr. 43, datë 17.01.1998 “Për organizimin e panaiereve dhe ekspozitave tregtare”, i cili është ndryshuar edhe 2 herë të tjera me VKM nr. 22, datë 21.01.1999 dhe VKM nr.438, datë 02.07.2004.

Pas diskutimit të këtij projektligji, nga anëtarët e KKB në mënyrë të vecantë nga Kryetari Z. Genc RULI u vendos rishikimi i këtij projektligji për disa pjesë të vecanta të tij duke rishikuar sygjerimet e e ardhura nga Dhoma e Tregtise dhe Industrise Tirane, si dhe anëtarët e tjere të KKB-se. Gjithashtu u vendos që Qendra Kombëtare e Panaiereve dhe Ekspozitave Tregtare e

parashikuar ne projektligj si nje qender per organizimin, promovimin dhe mbikeqyrjen e veprimtaive te panaireve te quhet Agjensia Kombtare e Panaireve dhe Ekspozitave Tregtare. Nga anetaret e KKB-se u sygjerua domosdoshmeria e krijimit te nje qendre per zhvillimin e panaireve dhe ekspozitave tregtare.